Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ
DEL DY HERE NE JAVE: T'EJTEN DHE TE DJELEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 94 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 122 | PRISHTINE, e ejte 8 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

Shtatë Korriku — Dita e kryengritjes popullore të Sërbis

Festen e kryengritjes se 7 korrikut ne Serbi, popujt t'one e kremtuen me nji hov e vullnet akoma ma te madh ne luften per realizimin e detyrve te vitit te dyte te Planit pesvjeçar, i cili, mbas shkatrrimit te pozitave kapitaliste ne qytet, do te kunorzohet me fitoret edhe ma te mdhaja e ma te randesishme ne rekonstruimin socjalist te bujqesis, ne rrugen drejte likuidimit te çfrytezimit ne katund. Diten e kryengritjes popullore te Serbis, popujt t'one e kremtuen me gara te gjithaneshme socjaliste, ne ndere te Kongresit te Peste te Partis s'one te lavdishme Komuniste; e kremtuen me sukese te randesishme ne Huan popullore, ne kontraktimin e drithnave, ne ndertimin e shtepijave kooperative, objekteve te ndryshme ekonomike e kulturale; me sukese te mdhaja ne ndertimin e Beogradit te ri, autostrades „Vllazimi e Bashkimi" — Beograd—Zagreb, ne ndertimin e hekurudhes Kuçevo—Brodice etj. Popujt e Kosmetit e shenjuen ket pervjetor me perfundimin e hekurudhes Prishtine—Kurshumli.

Ne diten e kryengritjes popullore te Serbis, popujt t'one kujtojne me nderim dhe mirenjohje vllaun e tyne te madh, popullin Serb, i cili me klasen e vet puntore ne krye u-ba flamurtar i luftes çlirimtare te popujve t'one per liri e pamvaresi, per Jugosllavin e re, si voter e popujve te vllaznuem e te bashkuem e me te drejta te barabarta. I drejton syt kah Partija e vet komuniste, me shokun Tito ne krye, qe na drejtoi me aq urti ne luften çlirimtare me arme per shkatrrimin e okupatorve fashista dhe veglave te tyne, nga rradhet e borgjezis; qe na drejtoi e na drejton, po me aq urti ne rindertimin e Vendit t'one e ne ndertimin e tij socjalist. I drejtojne syte kah popujt e Armata e Kuqe e Bashkimit te Madh vlla Sovjetik, t'udhehequn nga Partija e lavdishme Komuniste bolshevike, me shokun Stalin ne krye, te vetedijshem per rolin vendimtar t'atdheut te socjalizmit, ne luften çlirimtare antifashiste. Ne diten e shtate korrikut, popujt t'one i kujtuen, bijt dhe bijat e veta, qe ne kohen e vuejtjeve ma te mdhaja, para litarit e skuadrave pushkatuese t'okupatorit e te tradhtarve, e kane kqyre vdekjen me sy dhe e kane prite ate heroikisht, gjithmone me thirrjen „Stalin—Tito" ne goje. Ne diten e pervjetorit te kryengritjes popullore te Serbis, popujt t'one shprehen mirnjohjen e vet ndaj popujve te BRSS qe na kane dhane ndihme aq te çmueshme ne fushen ekonomike dhe, nepermjet te pajisjes s'Armates s'one me armatimin modern, ne forcimin e fuqis mprojtese te Vendit t'one. Shprehin nderlidhjen e tyne te pashkatrrueshme me Partin Komuniste te Jugosllavis, me Komitetin Qendruer dhe shokun Tito ne krye, dhe, nepermjet te kesaj, solidarsin e tyne te forte me shtetet e demokracis popullore dhe kampin demokratik botnuer, pergjithsisht, me BRSS ne krye, ne luften e perbashket kundra imperjalizmit, me magnatet e finances amerikane ne ball. Ne diten e kryengritjes popullore te Serbis, popujt t'one çfaqen besimin e patrandshem ne linjen e drejte, — linje e marksizem-leninizmit konsequent — te Komitetit Qendruer te PKJ, si ne politiken e mbrendshme, ashtu edhe n'ate te jashtmen, dhe indinjaten e vet te thelle per akuzat dhe shpifjet e pathemelta, te drejtueme kundra udheheqesis s'one, akuzat dhe shpifje, te cilat kane rrjedhe nga elementat tradhtare ne Partin t'one dhe nga moskuptimi i gjendjes dhe zhvillimit ke na.

Diten e kryengritjes popullore te Serbis, popujt e Kosmetit — shqiptave, serbe e malazeze e festuen me fitore te randesishme te mbrritiuna, neu udheheqjen e Partis Komuniste, qe drejton Frontin populluer, ne luften per zhvillimin e matutjeshem ekonomik dhe kultural te Krahines se vet, gja ne te cilen kane pase dhe kane gjithnji ndihmen vllaznore te popullit Serb dhe te te gjithe popujve te tjere t'atdheut t'one socjalist. Ket dite ata e kremtuen, tue i shtrengue edhe ma teper rradhet e veta rreth Partis s'one te lavdishme Komuniste dhe udheheqesis se saje me shokun Tito ne krye. Ata treguen se do t'a forcojne e zhvillojne edhe ma tutje vllazenimin e bashkimin, si ne mes te tyne, ashtu edhe me popujt e tjere te Vendit t'one treguen se Partija e jone na ka edukue dhe na edukon me frymen e dashtunis ndaj Bashkimit Sovjetik; çfaqen edhe nji here besimin e vet te thelle se Komiteti Qendror e PKJ e ka ndjeke dhe ndjeke linjen e drejte, linjen e luftes per transformimin socjalist te Vendit t'one.

Popullsija shqiptare e Krahines s'one, qe, ne saje te linjes se drejte te Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis ne çeshtjen narjonale, gezon te drejtat e barabarta kombetare me popujt e tjere vllazen t'atheut t'one si gjithe popujt tjere te Jugoslavis, i hjedhe poshte akuzat e padrejta te drejtueme Komitetit Qendror te Partis s'one Komuniste dhe i denon, si te pa deja dhe çnjerezore, aktet dhe metodat si ato te perdoruna nga udheheqsat e Shqipnis, popullit te se ciles popujt t'one i kane ndihmue me aq sinqeritet vllaznor si gjate gjith luftes se tij heroike çlirimtare me arme, ashtu edhe gjate perjudhes se rindertimit te vendit te tij te rrenuem dhe ndertimit te tij socjalist. Lanja e femijve te Jugosllavis pa buke ne Shqipni, se cilës popujt t'one kane qene gjithmone gadi me ia dhane e ia kane dhane si vllau vllaut edhe kafshoren e gojes, nuk mund te mos mbetet si nji kujtim i zi ne mendjet e njerezve t'one, pra edhe te shqiptarve te Jugosllavis, me gjithse kurrfar akti i panjerezishem dhe i padrejte nuk do te mundet kurre me i nda popujt e Vendit t'one nga populli i Shqipnis.

Shqiptaret e Kosmetit do t'i japin pergjigjen e duhun kujdo qi te hape parullen se qindrimi qe kane marre tash vone njerzit nga udheheqsija e Shqipnis, do te sjelle si rezultat humbjen e barazis se popullsis shqiptare ne Jugosllavi etj. kishoji.

Na e dijme se pozita e shqiptarve ne RFPJ nuk ka rrjedhe nga marredhanjet e mira ne mes te dy shteteve t'ona, porse nga linja e drejte e Partis s'one Komuniste te Jugosllavis, linja e te drejtave te barabarta per te gjithe popujt e Vendit t'one.

TRI NOTAT E QEVERIS SE RFPJ QEVERIS SE R.P. TE SHQIPNIS

Me 2 qershuer te ketij vjeti Qeverija e RFPJ ia dorzoi, me ane te legates shqiptare ne Beograd, Qeveris se R.P te Shqipnis keto nota:

NOTA E PARE

Ministrija e punve te jashtme e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis ka nderin me e njoftue Qeverin e R. P. te Shqipnis sa vijon:

Ne ditet e fundit pushteti shqiptar ka krye ne teritorin e Shqipnis nji seri gjestesh brutale e ofenduese drejtue ne rrezuemjen e autoritetit te RFPJ.

Pushteti i R. P. te Shqipnis, pa kurrfare shkaku, ka ndalue ne Tirane shitjen e gazetes „Borba", ka mbylle librarin „Libri jugosllav" dhe ka vendose rojen para saje.

Me 29 qershuer 1948 filloi hekja e fotografive te Kryetarit te Qeveris se RFPJ, marshalit te Jugosllavis Josip Broz Tito nga zyrat e shoqnive mikste. Keshtu drejtori i Institutit projektues Abdyl Kellezi thirri arketarin jugosllav Gregoriqin dhe deklaroi se ka urdhen me i hjeke fotografite e marshalit Tito nga zyrat.

Ndihmes-drejtori i Shoqnis per ndertimin e hekurudhave, Selim Allmerku, hyni ne zyren e drejtorit te shoqnis, Hujbnerit, dhe ne menyre brutale kerkoi te hiqet fotografija e marshalit Tito, tue tregue urdhnin per t'a hjeke e tue thane: „qe urdhni i kryetarit te qeveris se duhet te hiqen te gjitha fotografinat e Titos'." Dy ingjinjera te pranishem jugosllav e kundershtuen.

Profesori i gjuhes serbishte ne shkollen teknike, Radmilla Simeunoviq, me 29 qershuer te ketij vjeti u-thirr nga drejtori i shkolles, i cili ia komunikoi se marshali Tito asht tradhtar.

Gjesti dhe ofendimi i tille brutal kundra personalitetit te Kryetarit te Qeveris se RFPJ, marshalit te Jugosllavis Josip Broz Tito, nga ana e pushtetit shqiptar asht ne kundershtim flagrant me paktet e shumta dhe me marredhanjet miqsore nder mjet popujve dhe Vendeve t'ona. Gjestet e ketilla do t'ishin te pakuptueshme dhe te pa lejueshme edhe ne mes t'atyne vendeve, marredhanjet e te cilave kufizohen vetem ne durimin fqinjesor.

Mbi gjithe sa siper qeverija e RFPJ proteston ne menyre ma te rrepte prane Qeveris se R. P. te Shqipnis dhe kerkon qe aktoret e ketyne ofendimeve te thirren me dhane pergjegjesi, kundra tyne te bahen hetime dhe mbi rezultatet e ketyne hetimeve te njoftohet qeverija e RFPJ.

Qeverija e RFPJ shpreson se qeverija e R. P. te Shqipnis do t'i marre te gjitha masat per t'i pengue te gjitha çfaqjet eventuale te ketij llojit, te cilat u shkaktojne dame serjoze marredhanjeve reciproke miqsore. Perndryshej qeverija e RFPJ nuk konsiderohet pergjegjese per pasojet qe mund te rrjedhin nga kjo.

Qeverija e RFPJ edhe me kete rast dishron me theksue se gjesti i ketille i pushtetit shqipfar nuk do t'i ndryshoje ndjenjat e popujve te RFPJ ndaj popullit shqiptar.

NOTA E DYTE

Ministrija e punve te jashtme ka nderin me e njoftue qeverin e RP te Shqipnis sa vijon:

Qeverija e RFPJ asht e informueme:

E para:- Se drejtori i pergjithshem i Shoqnis shqiptare-jugosllave per ndertimin e hekurudhave, Hujbner, me 29 qershuer 1948, ka marre nji leter, me te cilen ministri i komunikacjonit te Republikes Popullore te Shqipnis, pa kurrfare arsyetimi, e urdhnon shoqnin te ndaloje me njihere punet per ndertimin e hekurudhes Shkoder—kufi dhe hulmetimet per ndertimin e hekurudhes Shkoder Tropoje dhe kufi-Kukes-kufi.

E dyta:- se drejtorit te pergjithshem te shoqnis shqiptare-jugosllave per nafte, Mevoldit, i asht komunikue me 30 qershuer 1948 pa kurrfare arsyetimi qe simbas urdhnit te ministrit te industris se Republikes Popullore te Shqipnis, asht ndalue çdo dergim i naftes dhe betumenit per Jugosllavi. Me aktin e ministrit t'industris se Republikes Popullore te Shqipnis, me 30 qershuer te ketij vjeti, urdhnohet shoqnija shqiptare-jugosllave per nafte dhe shoqnija mikste per minerale, qe deri me urdhnin tjeter t'i ndalojne te gjitha dergesat per Jugosllavi, tue perfshi ketu edhe dengat me malina ne limanin e Durrsit dhe ne Vlone.

E treta: me rastin e ngarkimit e shkarkimit te vaporreve jugosllave gjendja asht keqesue dita dites. Deri sa ne muejin maj te ketij vjeti norma mesatare e ngarkimit mbrenda dites ka qene 862 tonelata me 270 puntore dhe 115 mjete transporti ne muejin qershuer kjo norme ka ra ne 621 tonelate, me gjithe faktin se numri i puntorve asht shtue aproksimativisht ne 310, numri i mjeteve te transportit 212 dhe se jane fitue 100 metra limani te ri operativ. Kjo gjendje asht keqesue ma teper me 27 e 28 te muejit qershuer, kur jane shkarkue ase ngarkue nga tri vaporet e mdhaja jugosllave aproksimativisht 300 tonelata ne dite, ndaj faktit se RFPJ i ka dergue Republikes Popullore te Shqipnis me keto vapore cimentin shum te nevojshem per ndertimin kapital dhe materjale tjera.

Tue marre parasyshe faktet tjera te paraqituna ne ket note, asht e kjarte se keqesimi i ngarkimit dhe shkarkimit asht llogaritе me qellim qe nga nji ane t'i shkaktohen dame lundrimit detar jugosllav, e nga ana tjeter te bahet i pamundeshem bashkpunimi ekonomik jugosllavo-shqiptar.

(Vazhdon ne faqen 2)

Regjistrimi i Huas popullore

Tue i tejkalue obligimet e veta te marruna persiper njerzit t'one te punes tregojne se mbeten te paperkulshem ne linjen e Partis dhe te KQ te PKJ me shokun Tito ne krye

Regjistrimi i Huas popullore po zhvillohet me sukses. Numri i madh i te regjistruemve si dhe shumat e mdhaja qe regjistrohen per Huan popullore tregojne patriotizmin e nalte dhe unitetin moralo-politik te popullit t'one. Regjistrimi i Huas popullore ne Krahinen t'one ka marre karakterin e pergjithshem populluer. Me mija njerez te punes simbas shembullit te pararojes se vet — klases puntore, po i tejkalojne obligimet e marruna persiper dhe tue e krye ket detyre nderi ndaj atdheut t'one socjalist, po e tregojne dashtunin e vet te thelle ndaj Partis s'one Komuniste dhe Komitetit Qendruer, me shokun Tito ne krye.

Veçanerisht, jane korre rezultate te mira ne rrethin e Mitrovices si dhe neper qendrat ma te mdhaja te Krahines s'one. Ne sipermarrjet e shumta dhe ne te gjitha vendet e punes asht regjistrue Huaja popullore qind per qind. Gjithashtu jane korre rezultate te mdhaja edhe ne shumicen dermuese te katundeve t'ona.

Regjistrimi vazhdon. Mbrenda dites 6 korrik jane regjistrue ne rrethin e Mitrovices 949.000 dinare, ne rrethin e Lipjanit 771.000 dinare, ne rrethin e Gjakoves — 723.000 din., ne rrethin e Rahovecit — 701.000 etj.

PREJ FILLIMIT TE REGJISTRIMIT TE HUAS E DERI NE MBRAMJEN E DATES 6 KORRIK JANE REGJISTRUE NE KRAHINEN T'ONE 86,611.000 DINARE

Rrethi i Mitrovices	10.371.000 din.
rrethi i Rahovecit	7.455.000 „
qyteti i Prishtines	6.833.000 „
rrethi i Pejes	5.744.000 „
rrethi i Ferizajt	5.628.000 „
rrethi i Gjakoves	5.304.000 „
qyteti i Mitrovices	4.933.000 „
rrethi i Gjurakovcit	4.933.000 „
rrethi i Lipjanit	4.803.000 „
qyteti i Prizrenit	4.189.000 „
rrethi i Gillanit	3.619.000 „
rrethi i Srbices	3.486.000 „
qyteti i Pejes	3.396.000 „
rrethi i Prishtines	2.653.000 „
rrethi i Vuçiternes	2.643.000 „
rrethi i Podujeves	2.611.000 „
rrethi i Suharekes	2.313.000 „
rrethi i Prizrenit	2.226.000 „
rrethi i Kamenices	1.881.000 „
rrethi i Dragashit	1.590.000 „

E PERSHENDESIM KOMITETIN T'ONE QENDRUER HEROIK DHE KERKOJME QE TE NA UDHEHEQE ME URTI EDHE NE T'ARDHMEN NE LUFTE PER NDERTIMIN E SOCJALIZMIT

Komitetit Qendruer te PKJ

BEOGRAD

Te mbledhun sot ne Konferencen e Partis per rrethin e Prishtines, per t'i zgjedhe delegatet per Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, pershendesim KQ te PKJ, me shokun Tito ne krye, dhe premtojme se nen udheheqjine t'Uej t'urte do t'a vazhdojme me hov edhe ma te madh luften per ndertimin e socjalizmit dhe per realizimin e programit te Partis s'one.

Njikohesisht pershendesim deklaraten e KQ te PKJ me rastin e Rezolutes se Byros Informative, me te cilen e kane gjykue politiken e Partis s'one ne menyre te padrejte dhe te pavertete, me te cilen gja na asht ba padrejtesija ma e madhe historike.

Ne lidhje me kete, shprehim dashunin dhe besnikrin e organizates s'one te Partis ndaj shokut Tito dhe Komitetit Qendruer te PKJ, te vetedijshem se te gjitha keto sukses i kemi arrijte ne saje te linjes se drejte dhe te udheheqsis se sigurte te KQ te PKJ, me shokun Tito ne krye.

Na jemi te sigurte se kurkush, pervec anmiqeve te Partis s'one sic jane Zhujoviq e Hebrang, ndryshej as nuk mund te mendoje as te flase; e shprehim gjithashtu sigurin t'one se kurkujt nuk do t'i shkoje perdore me e thye kompaktesin e Partis s'one. Na edhe tash e tutje do t'a ushqejme dashunin e sinqerte ndaj Bashkimit Sovjetik ne krye te te cilit gjindet Partija Bolshevike dhe shoku Stalin.

Rrnofte Kongresi i Peste i Partis Komuniste te Jugosllavis!

Rrnofte KQ i PKJ me shokun Tito ne krye!

KONFERENCA E PARTIS PER RRETHIN E PRISHTINES

Prishtine, 3 Korrik 1948. —

Komitetit Qendruer te PKJ

BEOGRAD

Nga Konferenca e jone e Partis se qytetit Prishtine ku jemi mbledhe me zgjedhe delegatet per Kongresin e Peste te partis Komuniste te Jugosllavis, pershendesim KQ te PKJ dhe shokun Tito me deshire qe edhe tutje te na prijne ne lufte per ndertimin e socjalizmit ne vendin t'one sic na kane pri pa frige dhe ne menyre komuniste gjate luftes Nacional-clirimtare dhe gjate ndertimit te deritashem te Vendit t'one.

Kurrfare cpifjesh dhe akuzash te pavertela kundra Komitetit t'one Qendruer nuk do t'a shkatrrojne kompaktesin t'one as qe do t'a perkulin besimin t'one ne Komitetin t'one Qendruer dhe ne shokun Tito.

Jo me fjalina dhe citate te shkeputuna, jo me proklamata e rezoluta, por me lufte heroike e te vetmohueshme, Komiteti Qendruer dhe Partija e jone kane tregue dhe tregojne me vepra se jemi parti konseguente marksiste-lenjiniste, se kemi luftue dhe luftojme me konseguence per realizimin e programit te njerzve punues te Vendit t'one — per ndertimin e socjalizmit, se gjithmone kemi qendrue dhe qendrojme ne balle te bashkepunimit vllaznuer me luften e njerzve te punes te vendeve tjera me Bashkimin Sovjetik ne krye.

Vetem Komiteti i yne Qendruer, e kurrkush tjeter, e ka krijue dhe zhvillue nder ne komunistat dhe nder te gjithe njerzit e punes ne Vendin t'one dashunin ndaj Bashkimit Sovjetik, Partis Bolshevike dhe shokut Stalin.

Prandaj shpifjet qe drejtohen kundra Komitetit t'one Qendruer i konsiderojme si shpifje kundra Partis s'one dhe popujve t'one, te cilat nen udheheqjen e tij u-cuen ne lufte dhe siguruen clirimin e tyne socjal e nacjonal, korren sukses te medhaja ne ndertimin e socjalizmit dhe nen udheheqjen e tij shkojme me hapa te sigurte kah ardhmenija e vet e lumtun.

Emni Tito dhe emnat e bashkepuntorve te tij ne KQ te PKJ si dhe emni RFPJ jane kuptime te pandashme ne vetedijen dhe ne zemrat t'ona.

Na e duem Vendin t'one, Partin t'one, Komitetin t'one Qendruer; na krenohemi me suksesat t'ona te medhaja dhe konsiderojme se per ket kemi plote te drejte e askush s'ka te drejte me na e pa per te madhe mbasi kurre nuk e kemi nda as qe e ndajme luften t'one nga Fronti i pergjithshem i luftes se njerzve punuesa te vendeve tjera me Bashkimin Sovjetik ne krye.

Na jemi te sigurte se nuk do te shkoje gjate e ka me u-vertetue se te gjitha akuzat kundra KQ dhe Partis s'one jane krejte te trillueme dhe te pavertela. Deri atehere na do t'a vazhdojme rrugen dhe luften t'one, tue i shtrengue edhe ma forte rradhet t'ona rreth Komitetit t'one Qendruer, me shokun Tito ne krye. Dhe kahu as tash e mbrapa nuk do te na perkulin cpifjet e bile as marrezinat dhe gjestet cnjerzore te disa vendeve kundra Partis s'one dhe Vendit t'one.

Kongresi i Peste i PKJ le te jete shprehje e kompaktesis dhe solidaritetit se partis s'one, le te jete shprehje e shtrengimit te porte te rradheve t'ona rreth Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito, le te jete edhe nji deshmi e drejtesis se punes s'one dhe frytedhanes per ndertimin e mabitjesimin te socjalizmit ne Vendin t'one.

Rrnofte KQ i PKJ me shokun Tito ne krye.

Delegatet e Konferences se Partis per Qytetin e Prishtines

Pergjegjja e Qeveris se Republikes Federative Popullore te Jugosllavis notes se Qeveris se Shqipnis

Pa u-konsultue ma pare me Qeverin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis, Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis me akt te njianshem, i cili asht ne kundershtim me te gjitha parimet themelore te se drejtes nderkombetare mbi respektimin e obligimeve nderkombetare, me 1 korrik 1948 ia dorzoi Legates s'one ne Tirane noten mbi revokimin e te gjitha pakteve ekonomike dhe protokoleve ne mes te RFPJ dhe RP te Shqipnis, dhe, me 30 qershuer 1948 noten me te cilen kerkohet qe te largohen nga Shqipnija mbrenda 48 orve te gjithe eksperlat, teknikat, keshilltaret e profesoret, nenshtetas te RFPJ, te cilet Qeverija e RFPJ i ka dergue ne Shqipni me lutjen dhe ne marreveshtje me Qeverin e RP te Shqipnis per me i dhane ndihmen vllaznore popullit te Shqipnis ne rindertimin dhe ndertimin e vendit te tij.

Ne lidhje me kete, Qeverija e RFPJ ia dorzoi Qeveris se RP te Shqipnis noten me kete permbajtje:

Ministrija e punve te jashtme ka nderin me e njofte Qeverin e Republikes Popullore te Shqipnis sa vijon: ne noten e 1 korrikut 1948, Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis njoftoi Qeverin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis, se i revokon te gjitha paktet, marreveshtjet dhe protokolet ekonomike dhe i konsideron si te pavleftshme e te paqenuna.

Qeverija e Republikes Federative Popullore e Jugosllavis, mbasi e studjoi noten e marrun dhe propozimet e saja konstaton:

1. Dy paktet themelore ekonomike, mbi te cilat mbeshteten te gjitha paktet dhe protokolet tjera ekonomike ndermjet dy shteteve, jane pakti mbi harmonizimin e planeve ekonomike, mbi unjonin doganor dhe barazimin e valutes ndermjet Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Republikes Popullore te Shqipnis me 27 nandaer 1946, dhe marreveshtja mbi bashkepunimin ekonomik ndermjet Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Republikes Popullore te Shqipnis, me 1 korrik 1946. Keto parashofin afatin e 30 vjetve prej dites se nenshkrimit, pa te drejten dhe mundesin e palve kontraktuese qe t'i revokojne gjate ketij afati. Kjo asht vertetue perpikenisht dhe shprehimisht ne Nenin 4 te paktit mbi harmonizimin e planeve ekonomike etj. dhe ne Nenin 8 te marreveshtjes mbi bashkepunimin ekonomik.

Pakti mbi harmonizimin e planeve ekonomike etj. parashef qe mbas 30 vjetve, prej dites se nenshkrimit te paktit, vlera e ketij paktit do te shtyhet heshtazi per perjudha te reja prej dhjete vjetesh, tue perjashtue rastin e revokimit, e ky revokim duhet te notifikohet me shkrim nga ana e njenes qeveri te njenit prej shteteve kontraktuese qeveris tjeter se paku nji vjet para skadimit t'afatit te paktit.

Te gjitha paktet, marreveshtjet dhe protokolet tjera te cituese ne noten e Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis vetem jane aplikim i dy pakteve te siperme themelore, jane me te vertete pjese perbase te ketyne, e si te tilla e ndajne fatin e tyne juridik, ne se ne to nuk asht parapa shprehimisht dicka tjeter.

Prandaj, as Republika Popullore e Shqipnis as Republika Federative Popullore e Jugosllavis, para skadimit t'afatit te paktit nuk mund t'a shkeputin njianshem marredhanjen simbas paktit te mbeshtetun ne tekstet e siperme, e qe kjo te mos perfaqesoje prishjen brutale te pakteve ne fuqi, gja qe asht ne kundershtim te dukshem me parimet themelore te se drejtes nderkombtare mbi respektimin e detyrimeve nderkombtare.

Akti i Republikes Popullore te Shqipnis asht, prandaj, shkelje brutale dhe antiligjore e pakteve ne fuqi, te cilat ajo jo vetem nuk mundet me i revokue para skadimit t'afatit te pakteve, por aq ma pak me i konsiderue te pavleftshme e te paqenuna, sepse te gjitha keto fakte jane lidhe e ratifikue drejte, konform me dispozitat konstitucjonale te te dyja vendeve dhe me te drejten nderkombtare.

2) Jane te pavertela dhe arbitrare thanjet e Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis se Qeverija e Republikes Federative Popullore e Jugosllavis nuk i ka krye besnikerisht dhe si duhet detyrimet e saja nga paktet e lidhuna. Perkundrazi, ne se ndonjeni prej ketyne pakteve deri tash nuk ka qene i kryem plotesisht, mos kryerja ka rrjedhe vetem me fajin e Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis, e cila detyrimet e saja sa nuk i ka krye por bile edhe ka penguar qe paktet te zbatohen si duhet. Ne lidhje me te gjitha keto pakte Republika Federative Popullore e Jugosllavis i ka krye detyrimet e saja larg pertej proporcjonit i cili i pergjigjet pjeses qe i ka andne afati dhe pjeses se kryeme te detyrimeve nga ana e Republikes Popullore te Shqipnis.

3) Edhe sikur Qeverija e Republikes Popullore e Shqipnis do te konsideronte se kryemja e deritashme e pakteve nga ana e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis ka dhane shkak per mosmarreveshtje eventuale, Qeverija e Republikes Popullore e Shqipnis nuk ka mundje t'a perdori revokimin e njianshem. Perkundrazi, ajo ka qene e detyrueshme qe, ne pajtim me nenin 5 te paktit mbi miqesin dhe ndihmen reciproke ndermjet Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Republikes Popullore te Shqipnis, i nenshkruem me 9 korrik 1946, i cili i detyron te dyja qeverit, t'a perdori menyren ma te sinqerte miqesore te zgjidhjes qe asht parapa simbas ketij paktit per shqyrtimin e te gjitha cashtjeve te shtruene ndermjet tyne, e prandaj edhe per zgjidhjen e mosmarreveshtjes se ketille. Mirepo, Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis jo vetem nuk perdori menyre e ketille te zgjidhjes se gjoja mosmarreveshtjes, por, deri me 28 qershuer 1948, nuk ka parashtrue kurrfare cashtjeje te ketij lloji. Perkundrazi, perfaqesuesat e Qeveris se Republikes Federative Popullore te Jugosllavis u kane terhjeke vrejtje miqesore organeve te Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis, tue i ftue per eleminimin e pengesave qe kane qendrue ne rrugen e kryemjes se drejte te detyrimeve.

Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis gjithmone deri tash e ka vue ne dukje mirenjohjen ndaj Qeveris se Republikes Federative Popullore te Jugosllavis per ndihmen e pakursyeme qe ia ka dhane Republika Federative Popullore e Jugosllavis Republikes Popullore te Shqipnis dhe popullit shqiptar, ne baze te pakteve te cituese.

4) Qeverija e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis konstaton se saldoja aktive e ndihmes Jugosllave qe i asht dhane deri tash Republikes Popullore te Shqipnis asht afro 2 miljarda dinare, e se Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis me gjith premtimet e dhanuna ka evitue me e rregullue ket cashtje ne pajtim me nenin 4 te marreveshtjes mbi kredin e 2 miljarde dinarve, t'aprovueme per rindertimin ekonomik te Republikes Popullore te Shqipnis, i cili nen thote: "afatet dhe kushtet e kthimit te kredis do te caktohen mbasandej me marreveshtje ndermjet dy qeverinave".

5) Qeverija e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis konstaton se nga vellimi i pergjithshem i bashkepunimit te deritashem ekonomik, i cili kapet ne afer 3 miljarde e 100 miljona dinare, gjithsejt vetem 18,4% kane lype ne dobi te Republikes Federative Popullore te Jugosllavis, ndersa ne dobin e Republikes Popullore te Shqipnis kane shkue afro 81,5%. Prandaj Republika Popullore e Shqipnis ka marre 4 here ma teper se Republika Federative Popullore e Jugosllavis. Ky fakt, fund i fundit, i pergjigjet edhe frymes edhe tekstit te te gjitha pakteve te cilat po i revokon ne menyre antiligjore Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis. Mirepo, asht e dijtun se te gjitha keto pakte kane pase per qellim qe Republika Popullore te Shqipnis, tue marre parasyshe ekonomin e pazhvillueme dhe shkatrrimet e medhaja gjate luftes, t'i epet ndihma sa ma efikase vllaznore. Saldoja aktive e ndihmes se thjeshte qe i ka dhane Jugosllavija Republikes Popullore te

(Vazhdon ne faqen e trete)

Tri notat e Qeveris se RFPJ Qeveris se R. P. te Shqipnis

(Vijon nga faqja e pare)

Qeverija jugosllave konstaton se faktet e naltpermenduna jane jo vetem shkelje brutale e pa kuptueshme per kuptimet normale te detyrimeve nderkombetare dhe bashkpunimit nderkombetar e pakteve ne fuqi ndermjet RFPJ dhe RP te Shqipnis, por perfaqesojne edhe nji akt brutal drejtue kundra RFPJ, i cili asht aq ma i cuditshem, mbasi asht e dijtun se dy te tretat e vellimit te bashkepunimit ekonomik te lidhun ndermjet Jugosllavis e Shqipnis jane thjeshte ndihme Republikes Popullore te Shqipnis nga RFPJ. Per kete ndihme thjeshte ekonomike, te cilen qe dy vjete RFPJ ia jep Shqipnis, Republika popullore e Shqipnis nuk i jep RFPJ kurrfare kundravlefte.

Qeverija e RFPJ thekson mandej se me pakte asht parapa qe kjo ndihme e thjeshte te rregullohet formalisht. Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis, e cila ne muejin prill 1948 ka pranue qe per kete qellim t'a dergoje delegacjonin e saje ne Beograd, qe dy muej shmanget me e zbatue ket konkluze.

Me gjestet e ketilla Qeverija e RP te Shqipnis jep me besue se kjo shmangeje asht ba me qellim qe me 29 e 30 qershuer te mund te bahej shkelja e pakteve ne fuqi.

Qeverija e RFPJ deklaron se gjestet qe cfaqen nga ana e Qeveris se Shqipnis n'aktet e saja te 29 e 30 qershorit, jane krejt te palejueshme jo vetem ndermjet vendeve mike, por edhe ne bashkepunimin ma te thjeshte nderkombetar.

Ne baze te gjith sa siper Qeverija e RFPJ kerkon:

a) qe Qeverija e R. P. te Shqipnis t'i terhjeke aktet e naltepermenduna te 29 e 30 qershorit te ketij vjetit,

b) qe Qeverija e R. P. te Shqipnis, sa ma pare te jete e mundun t'a dergoje ne Beograd delegacjonin me qellim qe te rregullohen cashtjet e parregullueme te bashkepunimit ekonomik, simbas marreveshtjes se muejit prill te vjetit 1948.

c) qe Qeverija e R. P. te Shqipnis t'a njoftoje perfaqesuesin e legates Jugosllave ne Tirane se kur deshron me e dergue delegacjonin e permendun ne Beograd.

Qeverija e RFPJ shpreson se Qeverija e RP te Shqipnis do t'i ndaloje gjestet e ketilla dhe te ngjajshme te cilat perfaqesojne prishjen e pakteve ne fuqi. Per ndryshej, Qeverija e RFPJ i terhjeke vrejtjen Qeveris se RP te Shqipnis se ajo do te jete pergjegjese per te gjitha pasojat qe te mund te burojshin nga kjo.

NOTA E TRETE

Ministrija e punve te jashtme te RFPJ ka nderin me e njoftue Qeverin e RP te Shqipnis sa vijon:

Me 24 qershuer 1948 n'ora 20 koloneli Spiro Srzentiq, instruktor i Drejtoris kryesore politike t'Armates prane Drejtoris politike t'Armates Shqiptare asht thirre ne menyre jo te zakonshme nga shefi i Shtabit madhor t'Armates Shqiptare gjeneral-major Beqir Balluku ne zyren e ndihmes-ministrit te mprojtjes popullore, gjeneral-major Kristo Themelko, me te cilin rast gjeneral-major Themelko e njoftoi ne menyre ofenduese se duhet te largohet me nji here nga Shqipnija. Njikohsisht shefi i Gjeneralshtabit, gjeneral-major Balluku ne menyre jo te deje ka cpife kundra RFPJ dhe udheheqsave te saje.

Mirepo, Qeverija e RP te Shqipnis e sidomos Ministrija e mprojtjes popullore te Shqipnis, fare mire e din se koloneli Srzentiq ka shkue ne Shqipni simbas kerkeses se Qeveris se RP te Shqipnis. Deri tash as Qeverija e Shqipnis as Ministrija e mprojtjes popullore nuk jane ankue kundra punes dhe qendrimit te kolonelit Srzentiq, por perkundrazi kane vue ne dukje punen e tij te vetmohueshme dhe ndihmen qe i ka dhane Armates Shqiptare.

Per shkak te gjith sa siper, gjesti i gjeneralave te permendun ndaj kolonelit Srzentiq flet mbi sulmin me qellim kundra autoritetit t'Armates s'one dhe perfaqesuesave te saje ne Shqipni, kundra autoritetit te Vendit t'one dhe popujve t'one. Ky gjest asht shkelje brutale e marreveshtjeve dhe u shkaktoon dame serjoze marredhanjeve miqsore ndermjet dy vendeve t'ona.

Qeverija e RFPJ proteston ne menyren ma energjike kundra gjestit te ketille te pashembullt ofendues ndaj perfaqesuesit t'Armates Jugosllave, kundra cpifjeve brutale ndaj RFPJ dhe udheqsave te saje, dhe kerkon qe Qeverija e RP te Shqipnis t'i terhjeke keto cpifje dhe fajtoret t'i thirre ne pergjegjesine ma te rrepte.

Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis

Deri ne diten e hapjes se Kongresit te Peste ne Krahinen t'one do te kryhet ndertimi i 33 shtepijave kooperative

Ne Krahinen t'one do te nderiohen sivjet 174 shtepi kooperative. Deri tash jane fillue punimet per ndertimin e 143 shtepive kooperative. Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis jane marre persiper obligime qe deri ne diten e Kongresit te kryhet ndertimi i 33 shtepive kooperative.

Ne rrethet: Prishtine, Gilan, Gjakove, Drenice, Rahovec e Suhareke kane fillue punimet per te gjitha shtepijat kooperative, te parapame per t'u ndertue ne keto rrethe. Edhe rrethet tjera kane marre persiper obligimin e ri se deri ne diten e mbajtjes se Kongresit do te fillohen punimet ne te gjitha vendet e ndertimit.

Rezultatet ma te mira jane mbrrijte deri tash ne rrethin e Gjakoves, Gilanit dhe Prishtines. Ne keto rrethe jane tue vazhdue punimet per ndertimin e te gjitha shtepijave te parapame me plan. Brigadat puntore jane tue ba gara neper te gjitha vendet e ndertimit.

Veçanrisht asht tue u-zhvillue me hov puna per ndertimin e 33 shtepijave kooperative, te cilat do te kryhen deri ne diten e Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Ne vendet e ndertimit asht ne perfundim e siper puna rreth rrafshimit te murreve. Shtepia kooperative ne Komoran asht tue iu vue kulmi.

Mbare popullsija e vendeve, ku po ndertohen shtepijat kooperative i asht perveshe punes me hovin ma te madh per t'i krye obligimet e marruna persiper ne ndere te Kongresit te Peste te Partis s'one Komuniste, tue e shprehe ne ket menyre dashunin e pakufishme ndaj Partis dhe ndaj shokut Tito si dhe gatshmenin per te kontribue me te gjitha fuqit per ndertimin socjalist te Vendit t'one.

Puntoret e minjeres „Golesh" i jane perveshe me hov punes per realizimin e obligimeve te marruna persiper

Ne minjeren Golesh zhvillohen me hov te madh garat e punes ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Kolektivi i minjeres me fjale u ka shpalle gara te gjitha minjerave te magnezitit ne Vendin t'one. Shpenzimet e prodhimit do te paksohen me 6%; oferta e magnezitit do te shtohet me 152%, mrrima e bajtjes se madenit me ane te vijes industrijale dhe kamjonave do te tejkalohet me 20%. Sherbimi teknik ka marre persiper me hartue projektin per shtimin e prodhimit me 100%. Me gjithe se shum nepunesa kane shkue ne pushimin veruer, ata qe kane mbete kane marre persiper me i azhurue (perfundue) llogarinat ase aktet deri me 30 qershuer. Drejtorija e ripermarrjes i ka ngarkue velites si detyre me porosite disa vegla te nevojshme dhe me e shtue kapacitetin e centralit elektrik me 100%. Prodhimi i gmullinit duhet te shtohet 100%. Seksjoni i maqinave ka me ndreqe 15 vagona te dukuem 40%. Ka me u plotesue plani i kuadrove, mbajtjes se kurseve, aftesimit te puntoreve 100%.

Simbas lajmeve ma te reja, disa detyrime te marruna persiper tashma jane krye, si fjala vjen ne lidhje me centralin e elektrikut, shtimin e prodhimit dhe mullinin. Asht per t'u vue ne dukje lufta qe bajne shoferat per bajtjen e shpejt te madenit nga Goleshi ne Liplan, me gjithe rrugen shum te keqe. Ndonse uji i Sitnices e ka mbulue rrugen nga nji here deri 80 cm. naltesi shoferat kane mujte me bajte rregullisht e dite per dite nga 9 here per nga nji vagon maden.

Minjera e Goleshit u ka shpalle gara te gjitha minjerave te llojit te vet ne Jugosllavi. Se si zhvillohet gara ne kete minjere, mjafton t'i permendim disa shembuj. Grupi i Daut Ajetit punon ne furren nr. 3 dhe furren nr. 5. Dy pjese te ketij grupi i kane shpalle gara njena tjetres. Furra nr. 5 asht pjeke per 2 dite dhe 8 ore (ndrrimet punojne naten e diten). Furra nr. 3 asht pjeke per dy dite e 10 ore. Keto furra ne kohen e Jugosllavis se vjeter per t'u pjeke kane zgjate prej 5 deri 8 dite. Jo vetem kaq. Edhe kualiteti tashti asht ma i nalt. Ne furren nr. 3 punojne puntoret Haxhi Ajdini, Reshep Haziri, Islam Mehmeti. Ne furren nr. 5 Qerim Hajredini, Sherif Emrullahu, Tafil Tahiri.

Neper tabelat e ndryshme qe jane vue ne vendet e dukshme dallohen emnat e puntorve punuesa dhe grupeve ma te mira: grupit te Rexhep Zejnullahit, emni i Sejdi Osmanit, qe i thrret te gjithe shoket e vet ne gare, emni i Tafil Shyqris etj.

Pergjegja e Qeveris se Republikes Federative Popullore te Jugosllavis notes se Qeveris se Shqipnis

(Vijon nga faqja e dyte)

Shqipnis-rreth 2 miljarde dinare-asht deshmija ma e mire se jane trillue çpifje te pashembullta mbi qellimet dhe gjestet eksploatuese Jugosllave ndaj Republikes Popullore te Shqipnis.

Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis i asht propozue qysh para tre muejve me i dergue perfaqesuesat e saje ne Beograd per rregullimin dhe caktimin definitiv te detyrimeve te siperme me nji protokol, te cilat detyrime i ka marre mbi vehte dhe i ka krye vullnetarisht Qeverija e Republikes Federative Popullore e Jugosllavis, tue dishrue qe ne ket menyre pa e shtye t'a ndihmoje Republiken moter te Shqipnis. Por Qeverija e Republikes Popullore e Shqipnis deri ne ket moment asht shmange me dhane çfardo garancije ose obligimi per mjetet materjale, si keto qe jane permende ne piken kater, ashtu edhe tjerat e sidomos mbajtja e Armates Shqiptare, qe e kaperoen shifren prej 1 miljard e 500 miljon dinare ne vjet, e blle pa armatim. Kuptohet se Jugosllavija nuk mundet me i dhane Shqipnis afro 4 miljarda dinare ne vjet, gja qe asht sakrifice shum e madhe materjale per popujt t'one, pa nji garanci dhe obligim te tille nga ana e Shqipnis. Por nga qendrimi i deri-sotshem i Qeveris Shqiptare shifet kjartas se ajo nuk ka pase per qellim me dhane nji garanci te tille, por me shtynjen dhe heshtjen e saje asht perpjeke me nxjerre prej Jugosllavis sa ma shum mjete materjale e mbasandaj ne menyren ma brutale me çpife kundra saje, tue konsiderue se keshtu asht çlirue prej te gjitha obligimeve.

Tue konstatue gjendjen e tanishme juridike dhe tue ia rezervue Republikes Federative Popullore te Jugosllavis te gjitha te drejtat qe burojne nga kjo, Qeverija e Republikes Federative Popullore e Jugosllavis, tue marre parasyshe faktin se Qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis asht perfaqesuesi ma i nalt i pushtetit administrativ ne Republiken Popullore te Shqipnis, me gjithse e bindun se paktet e cituene kane qene nji sakrifice e madhe e popujve te Jugosllavis ne dobi te popullit shqiptar, asht e detyrueme me e marre ne dijeni revokimin e pakteve te permenduna, tue ia lane qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis pergjegjesin per pasojat e premjes se ketyne pakteve. Por, me ket rast nuk e pranon thezen e qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis se keto pakte jane te pavlefshme e te paqenuna.

Qeverija e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis vren dhe konstaton se revokimi i njianshem dhe antiligjuer i pakteve nga ana e qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis asht gjithashtu ne kontradite te plote me Paktin mbi miqesin dhe ndihmen reciproke dhe se faktikisht don me thane shkelje e ketij paktit nga ana e Republikes Popullore te Shqipnis.

Ne historin e deritashme te marredhanjeve diplomatike asht gja e padigjueme qe njianeshem dhe ne menyren ma brutale, kundra interesave te vendit te vet, te shkelet pjesa e pakteve ne fuqi, tue ofendue palen kontraktuese ne menyren ma brutale, te perzehen nga Shqipnija ne menyre armiqesore ekspertat ushtarake dhe t'ofendohen ne menyren ma brutale Armata e jone dhe udheheqesat e saje, me te cilen gja ajo vet e shkele Paktin mbi miqesin dhe ndihmen reciproke e njikohesisht thekson ne poten e saje se mbetet ne fuqi Pakti mbi miqesin dhe ndihmen reciproke ndermjet dy vendeve.

Persa i perket tonit te notes se qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis dhe fakteve te trillueme qe permenden ne te se si gjoja qeverija e Republikes Federative Popullore e Jugosllavis asht shkeles i paktit dhe se si e paska pengue zhvillimin ekonomik te Republikes Popullore te Shqipnis, e ka çfrytzue Shqipnin, etj. — te gjitha keto hyjne ne rrethin e propagandes s'oragnizueme qe ne kohen e fundit zhvillohet kundra Republikes Federative Popullore te Jugosllavis.

Qeverija e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis thekson se ne pikpamje te borxheve te parregullueme te Republikes Popullore te Shqipnis ndaj Republikes Federative Popullore te Jugosllavis mbetet ne kerkesen e saje te paraqitun ne noten e nji korrikut 1948 dhe njikohsisht e konsideron qeverin e Republikes Popullore te Shqipnis pergjegjese per pasojat qe dalin nga nota e saje e nji korrikut te ketij vjetit.

Ministrija e punve te jashtme perfiton edhe nga ky rast qe legates se Republikes Popullore te Shqipnis t'i shprehi mirenjohtjen e saje.

Beograd, me 3-VII-1948

PERFUNDIMET E VJETIT SHKOLLUER NE GJIMNAZIN E PEJES

Ne vitin shkolluer 1947/48, gjimnazi real shtetnuer i Pejes, hyn ne vitin e dyte te punes se rregullt dhe normale mbas çlirimit.

Ne fillim te vitit shkolluer, ne saje te perpjekjeve t'arsimtarve, seksjonit arsimuer te qendres dhe organizates se Frontit populluer, per heren e pare ne historin e ketij gjimnazi, jane regjistrue te gjithe nxanesit qe kane krye klasen e IV-te fillores. Ne ket menyre numri i nxansve asht shtue prej vjetit te kaluem ne 150 nxanes e nxanese.

Ne fund te vjetit shkolluer kane qene gjithsejt nxanes e nxanese te rregullte 350, prej te cilve 31 femna, tue tregue kete perfundim: te shkelqyeshem 28, shum mire 101, mire 107, per riprovim ne seksjonin e vjeshtes ne nji ase dy lande 57 dhe 13 perserisin klasen.

Arsim e kulture

Per te paren here shkolla Normale e Gjakoves nxjerre mesues te kualifikuem

Me daten 28 qershuer 1949, ne mbramje, ne lokalin e ri te shkolles normale u-shtrue nji darke prej drejtoris se shkolles me rastin e mbarimit te provimeve te pjekunis te nxansve te pare.

Per popullin shqiptar te Kosmetit ky asht nji aveniment nder ma te randesishmit te historis se tij: per here te pare dalin mesues te kualifikuem prej nji shkolle te rregullt ne Jugosllavi, e kjo ngjane ne pushtetin e ri populluer, ne votren e lire te popujve te barabarte. Keto jane frytet e Luftes Nacjonal-Çlirimtare e cila, u-ba prej bijve ma te mire te popujvet t'one dhe, sot me zbatimin e Planit pesvjeçar hape perspektivat e lumtuna per te gjithe popujt t'one. Sot, populli shqiptar ka te drejte te jete kryenalte per atdheun e tij te ri, per pushtetin e tij e per udheheqsin e organizatorin e fitoreve, Marshalin Tito.

Ngjarja e Normales ka randesi edhe pse pat vend pikrisht ne pragun e Kongresit te Peste te P.K.J. e cila qe e para qe dha kushtrimin kundra okupacjonit, shtypjes dhe çfrytezimit, tue e kethye Jugosllavin e kalbun te klikave reakcjonare, nga nji burg, ne nji kopsht lirije per popujt, ku lulzon vllaznimi e bashkimi e ku derdhet djerse e perbashket per nji t'ardheshme ma te mire e ma te lumtun e qe udheheqe popujt t'one drejte fitoreve per krijimin e socjalizmit n'atdheun e perbashket.

Provimet e matures fillnen me 15 qershuer dhe zgjaten deri me 25. Nga landet e provimeve kane qene: pedagogjija e pergjithshme, gjuhet shqip, serbisht dhe rusisht, historija dhe gjeografija e R.F.P.J.

Drejtorin e arsimit e perfaqsonte shoku Mehmet Gjevori, i cili njikohesisht ishte dhe kryetar i komisjonit provues. Gjithsejt u-paraqiten 38 kandidate, nga te cilet nji femen. Nga keta fituen provimin 31 dhe 4 mbeten per riprovim ne vjeshte e tre per perseritje mbas nji vjeti.

Ne darke asistoi Ministri i R.P. te Serbis shoku Risto Antunoviq dhe pergjegjesi i arsimit per Kosmet shoku Xhavit Nimani, si dhe perfaqesuesit e pushtetit populluer dhe t'organizatave masovike antifashiste. Per ndere te tyne, maturantat dhane pjesa theatrale: Lufiimi i çarshafit, „Doktori" dhe nji balete si dhe recitime prej copave te poetenve te rij.

Drejtori i normales shoku Beqir Kastrati u uroi miqve mirseardhjen dhe njikohesisht shprehu falenderimet e tij n'emen te nxansave per kujdesin e madh qe ka tregue pushteti i yne populluer per shkollen, tue ba qe, nxansevet te mos u mungoje kurgja, si ne shkolle, ashtu edhe n'internat. Mbas shokut Kastrati e muer fjalen ministri Antunoviq, i cili nder te tjera kujtoi historin e popullit shqiptar ne te shkuemen si edhe qellimet djallzore çfrytezuese te klikave antipopullore te maparshme dhe i ftoi maturantet e rij qe t'i vihen me mish e me shpirt punes ne shkolle per ngritjen e masave shqiptare krahas me popujt e tjere te Jugosllavis se re, t'apin gjithshka ne vrullin e realizimit te Planit pesvjeçar, ne menyre qe pionieret t'one te rriten me traditat fisnike te luftes Nacional-Çlirimtare dhe te pushtetit t'one populluer, te bahen roje besnike dhe e forte e çashtjes se popullit, te keshillave t'urta te shokut Tito e t'atdheut t'one te dashtun. Mandej e muer fjalen shoku Xhavit Nimani, i cili mbassi theksoi randesin e madhe te daljes se maturanteve te rij, si edhe kujdesjen e madhe qe ka pushteti populluer per arsimin e masave, iu drejtue maturantave tue u thane se ata nuk duhet te kufizohen vetem ma dijen e shkolles, por duhet t'a zgjanojne ate ma shum e sidomos, me u-njofte mire me shkencen marksiste-lenjiniste, me shkencen drite-dhanese te pikepamjes se drejte mbi boten dhe shoqnin, e cila zbuloi te verteten mbi shoqnin, hapi perspektiven e zhvillimit te marredhanjeve shoqnore dhe bani qe te hiqet çfrytezimi i njeriut mbi njeriun. "Shkenca marksiste-lenjiniste — tha shoku Nimani-ka me ju ndihmue qe t'a zbatoni si duhet detyren t'uej".

Folesit u-nderprene shpesh here nga thirrjet e te pranishemve per shokun Tito, Partin Komuniste, Jugosllavin e re dhe pushtetin populluer.

Mbramja gazmore zgjati deri n'oret e vona te nates.

T. H.

Perfundimet e provimeve te semimatures nder gjimnazet e paragjimnazet shqiptare

GJAKOVE:

Ne semimaturen e gjimnazit shqiptar mueren pjese nxansit e klases se trete dhe te katert. Prej 57 nxansve qe e kishin kalue klasen e trete, 12 u-liruen nga provimi si te shkelqyeshem, 8 mbeten per provimet e vjeshtes dhe nji mbeti per t'u paraqite ne provimet e semimatures ne vjetin e ardheshem. Te gjithe te tjeret e kaluen provimin.

Prej 40 nxansve, te cilet e kishin krye klasen e katert, 17 jane lirue nga provimi i semimatures si te shkelqyeshem, 10 kaluen ne provim dhe nji mbet ne provim per vjetin tjeter. Perfundimi qe i mire.

PRISHTINE

Ne gjimnazin shqiptar te Prishtines prej 50 kandidateve te semimatures te klaseve paralele te treta, 14 u-liruen nga provimi si te shkelqyeshem e shum te mire ne klase, 21 kaluen me perfundim te shkelqyeshem, shum te mire e te mire. Mbeten per riprovim ne vjeshte 15.

Prej klaseve paralele te katerta, prej 47 nxanesve kandidate u-liruen nga provimi 8, ndersa ne semimature kaluen 30. Mbeten per riprovimin e vjeshtes 7 dhe 1 per ne vitin tjeter. Nji nuk muerr pjese ne provim, mbasi ishte i smunde.

PRIZREN:

Ne gjimnazin shqiptar te Prizrenit ne provimet e semimatures pat perfundime te mira. Nder 55 kandidate ngelen ne riprovimet e vjeshtes dhete prej tyne dhe nji per ne vjetin tjeter.

GILAN:

Ne paragjimnazin shqiptar te Gilanit ne provimet e semimatures nder 47 kandidate kaluen 14. Prej shumes se pergjithshme te kandidatve, dy u-liruen nga provimi si te shkelqyeshem. Prej gjithe ketyne vetem njeni nuk u-paraqit ne provim, mbassi ishte i smunde.

SUHAREKE:

Ne klasen e III te paragjimnazit te Suharekes, prej 10 nxansve te rregullt kaluen shtate, prej te cilve tre me perfundim te shkelqyshem, nji shum te mire dhe tre me perfundim te mire. Mbeten per riprovim ne vjeshte dy, prej tyne dhe nji per perseritje klase, mbassi nuk ishte nxanes i rregullt.

Ne provimet e semimatures nxanesit me perfundim te shkelqyeshem jane lirue nga provimi, tre kaluen me perfundim te mire dhe njeni ngeli per vjeshte ne nji lande.

Tue u-mbeshtete ne rezultatet e vjetit shkolluer dhe te semimatures, asht per te vue ne dukje vullnetin e mire te mesuesve Veli Rexhepit dhe Ndoc Dedes, te cilet jane tregue mjaft aktiv, tue udhehege tri klase bolektive. Perveç kesaj, mesuesi Veli Rexhepi ka kontribue mjaft ne pune edhe jashta shkolle.

Po keshtu, vullneti ka qendrue edhe nder nxanesit, te cilet jane dallue edhe nga zgjuetaja. Tue qene se shumica e tyne jane te vorfen, do t'ishte mire qe pushteti Populluer te ndermarre per me iu sigurue bursa, ne menyre qe t'u jepet mundesija me i vazhdue studimet edhe nder klase te nalta te gjimnazit ose te shkolles Normale shqipe.

Për nji furnizim ma te mire te njerezve punuesa me peme, perime, bylmet dhe artikuj te ndryshem bujqesorë

Furnizimi i popullsis se qyteteve dhe vendeve ma te mdhaja me perime, peme dhe prodhime te ndryshme bujqesore asht problem i madh. Me gjithse jemi ne muajin korrik kur ka mjaft prodhime bujqesore e sidomos perime, gadi n'asnji vend te Krahines s'one, me perjashtim te Prizrenit, dyqanet shtetnore dhe kooperative nuk jane ende te furnizueme me patate te reja, bishtaja te njoma, bizele dhe prodhime tjera, qe jane teper te nevojshme. E njajta gja po ngjane edhe me pemet ne shumicen e rretheve t'ona.

Nga rjedh kjo gjendje? Arsyeja kryesore qendron ne faktin se sipermarrjet e furnizimit te qyteteve nuk angazhohen aq si duhet, mandej bashkimet kooperative te rretheve, drejtorinat e grumbullimit dhe kooperativat bujqesore nuk i jane pervesh kesaj pune me seriozitet. Tue qene se ne Krahinen t'one perimet dhe pemet piqen ma vone, sipermarrjet e qyteteve dhe te gjitha ato qe merren me blerjen e prodhimeve bujqesore asht deshte qe te lidhin kontrata, dy tre muej ma pare, me sipermarrjet e perimeve dhe te pemve si p. sh. ne Maqedoni ne Nish, Kraleve e vendet tjera, ne menyre qe t'ishin ne gjendje me e furnizue popullsin me perime, peme e prodhime tjera deri sa te piqeshin pemet dhe perimet ne Krahinen t'one. Mirepo, shumica e sipermarrjeve nuk e kane ba ket pune ne kohen e duhun, por kane kerkue me i lidhe kontratat ma vone, kur sipermarrjet e atyne vendeve jane obligue me u dhane perime dhe peme sipermarrjeve tjera jashta Krahines s'one, e te cilat jane kujdesue me kohe per furnizimin e njerezve puntore ne teritorin e vet. Per arsye te vonesës persa i perket lidhjes se kontratave pergjegjesat e sipermarrjeve te qyteteve t'ona jane te detyruem me shkue personalisht neper vise qe kane pune dhe perime dhe me ble ne treg te lire e me çmime shum te nalta. Nga kjo ka rrjedhe qe ne tregjet e atyne vendeve te ngrihen çmimet e artikujve te permendun, e per ket arsye ne shum vende organet e pushtetit populluer nuk lejojne qe te blehen prodhimet ne sasi ne treg te lire. Kjo asht nji nga arsyenat qe dyqanet e perimeve dhe te pemve nuk jane ende ne gjendje me e furnizue popullsin punuese te qytetit. N'anen tjeter çmimet e ketyne artikujve jane teper te nalta.

Nji nga arsyenat kryesore qendron edhe ne faktin se bashkimet kooperative te rretheve nuk e kane organizue ende blejmen e pemve dhe te perimeve si dhe t'artikujve te tjere bujqesore nga ekonominat e vogla shtepijake e ne baze te sistemit me çmimet e lidhuna, te cilat te dalin tash perimet dhe pemet e do t'i shesin me gjithe qef prodhimet e veta te tepruna per me muejte me u furnizue me artikuj te ndryshem industrijale. Kooperativat e vendeve dhe bashkimet kooperative te rretheve nuk jane tue ble ende artikuj te ndryshem nga ekonominat e vogla shtepijake nga se shum keshilla popullore te vendeve nuk i kane perpilue listat e ketyne ekonominave, te cilat simbas dekretit te Qeveris Qendrore, kane te drejte me shite me çmimet e lidhuna peme, perime dhe te gjitha prodhimet e veta bujqesore. Per kete arsye keto ekonomina te vogla jane te detyrueme me i shite prodhimet bujqesore ne treg te lire.

N'anen tjeter s'asht koordinim pune ne mes te sipermarrjeve te qytetit, bashkimeve kooperative te rretheve dhe kooperativave te vendit.

E njejta gja ndodhe edhe me prodhimet qumeshtore. Me gjithse qumesht ka mjaft, sipermarrjet e qyteteve nuk i kane kushtue gadi kurrfare kujdesi zgjidhjes se ketij problemi, sidomos nder qendrat ma te mdhaja, si ne Peje e ne Mitrovice, ku nuk jane çele ende dyqanet per shitjen e qumeshtit. Ne Prishtine jane hape sly dyqane, mirepo as keto nuk jane ne gjendje me i perballue nevojat e vendit dhe konsumuesit jane te detyruem me prite nga disa ore para ketyne tregtoreve. Sipermarrjet e furnizimit ne Peje dhe ne Mitrovice justifikohen se gjoja nuk kane ene, mjete transporti etj. Mirepo, ne konferencen qe asht mbajte ne keto dite me udheheqesat e sipermarrjeve shtetnore dhe kooperative, ne pranin e te deleguemit te Ministris se tregtis dhe furnizimit te RP te Serbis, asht konstatue se ka mjete transporti, ene dhe kushte te nevojshme, por mungon inicjativa dhe angazhimi i duhun. P. sh. bashkimi kooperativ i rrethit ne Mitrovice per mungese enesh thote se nuk ka pase mundesi me ble qumesht, kurse sipermarrja „Granap" i ka ma se 300 cope tenxhe voji dhe i a ka ofrue disa here bashkimit kooperativ, por drejtori ka harrue me ja thane ket gja personelit te vet, gja qe u-konstatue ne konferencen e nalipermendun. Po e permendim edhe nji shembull karakteristik te rrethit te Vuçiternes, ku simbas tregimit t'udheheqesit te drejtoris se grumbullimit te rrethit, shumica e blegtoreve te rrethit te Vuçiternes refuzojne me e shite qumeshtin pran sipermarrjeve shtetnore dhe kooperative tue thane se bagtija „do t'a ndale qumeshtin", mbassi keshtu e paskan paragjykime disa falltore te ketij rrethi. Kundra ketij qendrimi anmiqesuer nuk jane marre ende kurrfare masash, prandaj ne ket rreth blehen sasina fare te pakta qumeshti.

Atje ku egzistojne dyqanet per shitjen e qumeshtit dhe prodhimeve te tije si b. f. ne Prishtine gjinden sasina te vogla, qe nuk jane ne gjendje me i plotesue nevojat e njerzve te punes.

Per shkak t'organizimit te dobet te sipermarrjeve te furnizimit te qytetit dhe te bashkimeve te kooperative te rretheve prodhuesat jane tue i shite artikujt qumeshtore dhe prodhimet tjera bujqesore ne treg te lire e me çmime shum te nalta. Keshtu per shembull maza ose tlyni shitet prej 200–250 dinare, qumeshti 20 dinare, djathi 80–120 dinare etj. Keshtu, njerzit punuesa nuk jane ne gjendje me i ble.

Per me muejte me e evitue ket gjendje dhe me e permiresue furnizimin e popullsis se qyteteve, bashkimet kooperative te rretheve dhe sipermarrjet e furnizimit, me ndihmen e pushtetit populluer, duhet te marrin masa te shpejta per hapjen e qumeshtoreve ne qytete, te fillojne blemjen e perimeve, te qumeshtit dhe te prodhimeve te ndryshme bujqesore, ne menyre qe furnizimi te jete sa ma i mire. N'anen tjeter duhet te merren masa te shpejta per zbatimin e Dekretit ne lidhje me ekonominat e vogla shtepijake, ne menyre qe edhe keto te muejne me i shite me çmimet e lidhuna te gjitha prodhimet e veta bujqesore, gja qe ka me kontribue mjaft ne permiresimin e furnizimit te njerzve punuesa te qyteteve, e n'anen tjeter t'u epet mundesija qe edhe ato te furnizohen me artikuj te ndryshem industrijale.

Para gjyqit populluer te qarkut ne Prishtine dha hesape nji grup spijujsh te sherbimit informativ italjan

Ne keto dite dolen para gjyqit Shaip Mustafa, ish kryetar i gjyqit populluer te rrethit Prishtine, Hasan Rrema, Ali Hajdar Pasha dhe Pjeter Vuçaj tregtar prej Prizrenit, Millosh Begu, nepunes prej Kraleve, Radovan Spasiq, pensjonist prej Beogradit, Desanka Nikoliq, prej Nishit dhe Muhamet Emini ish industrijal nga Shkupi. Gjyqi vertetoi se shumica e te akuzuemve qysh para luftes ka punue ne sherbimin informativ italjan. Te tille jane: Hasan Rrema, Pjeter Vuçaj e Millosh Begu, te cilet kane qene te lidhun me rrjeten e sherbimit informativ italjan qysh ne vjetin 192[illegible], e Shaip Mustafa, prej vjetit 1935.

Qysh para luftes, Hasan Rrema nen masken si tregtar, shpesh here kalon kufinin Jugosllav prej Kuksit dhe shkon ne Gjakove, Prizren, Shkup, Beograd, Sarajeve, Podgorice dhe ne tjera vende, ku ka krijue rrjeten e gjane te sherbimit informativ fashist italjan "SIM". Ne keto vende ka ba mbledhje me bashkepuntoret e tij, prej te cilve ka marre referate me karakter politik e ushtarak.

Millosh Begu, per te paren here ka hye ne sherbimin informativ ushtarak italjan ne Prizren me 1928, e ma vone, simbas direktivave te pergjegjesave te tij, shkon ne Kraleve, ka ndrrue emnin, per me muejte me korre sukses me shpijunazhin e tij, ne popullsin serbe. Mbas okupimit te Vendit t'one edhe ma teper i forcon lidhjet e tija dhe fiton besim ma te madh prej organeve te sherbimit informativ italjan, tue dhane informata dhe mashtrue njerez te punojne n'interesat e sherbimit informativ.

Begu, me punen e tij aktive ka arrijte me ba per vehte Desanka Nikoliqin, prej Nishit, Svetisllav Gjuriqiqin prej Cupris, Sulejman Babiqin dhe shum te tjere, te cilet gjate kohes s'okupacjonit kane punue aktivisht ne sherbimin informativ italjan.

Ali Hajdar Pasha e Pjeter Vuçaj, gjate kohes s'okupacjonit, kane qene lidhe me inspektorin e federates fashiste Qeriten; keta kane qene krahu i djathte i tij. Shenimet per burgimin e internimin e perfaqsuesve te levizjes Nacional-Clirimtare ne Prizren keta ia kane dhane te permendunit. Radovan Spasiqit i asht ngarkue si detyre nga organet e sherbimit informativ italjan me organizue bashkepunimin ndermjet çetnikve e italjanve. Ky i con oficeral e sherbimit informativ italjan ke çetniket, prej te cilve fitojne shenime mbi levizjen nacjonal-çlirimtare dhe mbi njisit t'ona partizane te terenit te Jablanices. Ma i madhi kriminel i grupit te spijunazhit asht Shaip Mustafa i cili qysh ne vitin 1935 ka qene lidhe me spijunet italjane ne Beograd. Per te pase sukses ma te mira ne punen e tij spijunazhe, ka marre pjese ne levizjen e studentave perparimtare dhe asht lidhe me tu, ne menyre qe ne momentin ma te pershtatshem t'i kthente ata nga levizja antifashiste. Si shperblim per punen e tij tradhtare, Shaip Mustafa, se bashku me Sokol Dobroshin asht shperblye nga konsullata italjane me nji shum te madhe te hollash. Gjate okupacjonit vazhdon punen e tij te fliqet, tue u-perpjeke me çdo menyre me i ba pasive intelektualet e ndryshem, qe te mos marrin pjese ne luften Nacjonal-Clirimtare. Simbas autorizimit t'organeve te sherbimit informativ italjan ne vjetin 1941 ka organizue ne Shkup demostraten ne favor t'italjanve. Per kete pune asht burgos nga qeverija bullgare dhe asht internue ne Bullgari. Atje i ka ba vizite sekretari i konsullates italjane, keshtu qe Shaipi ka gezue te gjitha privilegjet, e mbas disa muejve lirohet nga burgu e vjen ne Shkup. Mbassi muer prej konsullates italjane nji shum e te madhe te hollash, kalon ne Kosmet, ku u ban vizite kuislingve ma te njoftun: Ferhat Beg Dragës, Bedri Pejanit, Ibrahim Lutfiut, spijunit Xhafer Deves dhe te tjerve. Ma vone niset per Tirane per me i ba vizite kryetarit te qeveris kuislinge, Mustafa Krujes, prej te cilit gjithashtu merr nji shum te madhe te hollash. Ne Tirane ka qendrue per nji kohe te gjate, por ma vone tue pa kapitullimin e Italis, vendose me e ndrrue pllaken, e me u-vue ne sherbim te gjermanve. Per kete i drejtohet me nji leter te njoftunit kriminelit e agjentit te gestapos, Xhafer Deves, te cilit i lutet qe te mos ia zente te madhe, mbassi tash e mbrapa do te bashkepunonte ngushtesisht me te.

Ky kriminel i madh ka ba çmos per me ruejte poziten e tij, e per me i mbushe xhepat me pare. Ky ne çdo vend asht paraqite si simpatizer i levizjes perparimtare, tue u-deklarue si antifashist, kurse ne te vertete ka qene trathtari tipik, spijun i sherbimit informativ italjano-gjerman.

Gjyqi i drejtesis se popullit te qarkut te Prishtines e gjykoi Shaip Mustafen me vdekje, kurse Hasan Rremen me 18 vjete, Ali Hajdar Pashen me 5 vjete, Pjeter Vuçen me 11 vjte. Milosh Begun me 14 vjete, Radovan Spasiqin me 12 vjete e Desanka Nikoliqin me 10 vjete burgim e pune te detyrueshme.

Vrella, si ne luften N. çl. ashtu edhe sot asht shembulli ma i shkelqyeshem per katundarin e Krahines s'one

Ne perjudhen e ndertimit socjalist te Vendit t'one, banoret e katundit Vrello (Lipjan) luftojne po me ate vetmohim, te cilin e kane tregue ne revolucjonin populluer. Po ndertojne at jete per te cilen jane perpjeke heroit e popullit — Boro Vukmiroviq dhe Ramiz Sadiku, luftetaret e vrame Boro Stankoviq, Aco Maroviq, Roberti, me shoke, qe kane punue mjaft kohe ne kete katund n'organizimin e kryengritjes popullore kundra pushtetit fashist e trathtarve te mbrendeshem. Po ndertojne jeten e re socjaliste, per hire te se ciles katundaret e Vrelles, burra, gra e femij, kane luftue pa pushim dhe kane hajte vuejtje e tortura gjate okupates fashiste, e madje edhe ma perpara tue i u- pergjegje gjithnjane zanit te Partis Komuniste te Jugosllavis.

Me formimin e kooperatives katundare te punes, me jeten e harmonishme te kolektivitetit te tyne, me zellin ne punen e perbashket, Vrella jep nji nga shembujt ma te shkelqyeshem per katundarin puntore te Krahines s'one; i tregon asaje se rruga e organizimit kooperatir, rruga e socjalizmit asht e vetmja rruge e mundshme per perparimin dhe lulezimin e gjithanshem te katundit, per t'i sigurue atij jeten ma te begatshme dhe ma te kulturueme.

Ne kooperativen katundare te punes „Stanko Buriq" jane perfshi 81 shpija. Ka do kohe, aty ka hye edhe mhare katundi Medvece — 43 shtepi jane shqiptare, malazeze dhe cigane — çka paraqet ne menyren ma te plote vllaznimin ne mes te popujve t'one — pa dallime. Ke antaret e ketij kolektivi po formohet nji shembellyre e re, shembellyra e ndertuesve te vetedijshem te socjalizmit, qe e shofin punen si çashtje nderi dhe krenarije. Kooperativa duket si nji zgjue bletesh puntore. Ke secili antar i saje mundesh me kuptue knaqesin qe ndien kah ia leshon vymin pasunis se madhe te perbashket: ma teper se katerqind hektare toke te punueshme, gadi 30 hektar livadhe, njiqind e katerdhet hektar kullota dhe ma teper se gjashtedhet hektar pyll. Maqina mbjellse per miser e grune, maqina per hedhjen e plehut artificjal, per kositjen e barit, per korrje e fshimje te granit, maqina per qerimin e misrit, grabuje e madhe per mbledhjen e sanes e qe terhiqet prej kuajvet dhe e kursen punen e dhete puntorve ne dite, — qe te mos flasim per lehtesimin e madh te punes se kositjes, e cila asht nga ma te veshtirat, pune e cila perpara kerkonte krahe te forte, kurse tashti kryhet edhe prej ma te dobtevet. Kooperativa e ka garnituren e farketaris, qe ndreqe almiset bujqesore. Fulla kafshesh, zgjoj bletesh etj.

Secjet kooperativa asht ma e forte. Antaret e saje kane ma shum eksperjence, e kane pervehtesue ma mire punen dhe mjeshtrin e zbatimit te masavet agroteknike. Ne punen e perbashket marrin pjese edhe femnat katundare. Prodhimi asht shtue ne sasi dhe permirsue ne cilsi. Ne plan parashifet nji perparim'i ndijshem.

Se çka fiton katundarija puntore nga organizimi kooperatir, po e tregojme me nji shembull karakteristik nga kooperativa ne fjale: aty jeton Nikolla Milaniq, 64 vjeç, vetem me plaken e vet e pa kurrkend tjeter ne shpi te tij. Micha Nikolla e ka marre persiper nji pune ma te lehte: i ruen qete e kolektivit. Po t'a pyetish se si jeton tashti, te pergjigjet me nji here: „Dodji mi kuci pa ceš vidjeti" (Hajdeni te shtepija e ke me pa!). Kur asht mbylle bilanci i vjeme i kooperatives, micha Nikolles i ka ra me marre per punen e tij: 545 kg. grune, 1055 kg. miser, 89 kg. tershane, 11,5 kgr. pasul, 157 kg. patate, 135 duj talle kollomboqi, 741 kg. sane, 637 kg. byk, perveç 4593.83 dinare pune ne dore dhe 105 dinare kamate vjetore per 1,5 ha toke qe i ka dhane ne kooperative. Micha Nikolla e ka sigurue per bukuri ushqimin dhe i ka teprue mjaft me shite e me ble me çmimet e lidhuna artikujt e nevojshem industrijale. Por mos te harrojme se perveç pasunis kolektive, ai ka edhe nji gjysem hektari toke rreth shpis, ku mbjelle per vehte zarzavate etj. —, ka kafshe t'imta per mish, pula etj. Ka pase edhe lopen per qumesht, por i ka cofe. Kooperativa do t'ia sigurole tjetren, si çdo shtepije antare te saje.

Secili leneri i ketyne rreshtave mund t'a marre veie me mend se si do te jetonte micha Nikolle — set plak 64 vjeç, me plaken e tij po aq te moçme pa asnji krah tjeter t'afte per pune, me nji hektar e gjymes toke, dhe te lige, pa qe lavre, pa almise bujqesore — ne menyren e vjeter, individuale, veçmas, si perpara.!?!

Prandaj asht krejte e kuptueshme se pse njerzit e kooperatives katundare „Stanko Buriq" punojne me aq entuziazem te paperskruem, pse gjithkah neper kete kolektiv buçasin kanget e herojvet te revolucjonit populluer dhe hymnet e ndertimit socjalist.

Ekspozita e nxansve n'ekonomi

Para disa ditesh ne Mitrovice asht çele ekspozita e punimeve te nxansve n'ekonomi te Stari Trgut dhe te Zveçanit, te nxansve te shkolles se mesme teknike, te shkolles femnore zejtare, te gjimnazit dhe te shkolles fillore. Nxanesit e ketyne shkollave profesjonale dhe nxanesit n'ekonomi i ekspozuen punimet e veta te ndryshme ne dhomat e dekorueme mire te shtepis se kultures. Nxanesit n'ekonomi te Stari Trgut ekspozuen vegla te ndryshme si p. sh. çekiqa, llampa minatoresh etj.

Punlocija e zdrukthetareve e ekspozoi kolektivisht nji tip ndertese, qe asht tue u-ndertue tash ne Zveçan per banesa puntoresh.

Nxanesit e shkolles se mesme teknike kane ekspozue vegla te ndryshme ne lidhje me landet e mesimit.

Nxaneset e shkolles femnore te zejtaris kane ekspozue nji numer te madh rrobesh, shamija te qindisuna, mbulоja te qindisuna fuvolinash etj. Ma se shumti kane ra ne sy ato t'Igballe Hirzis dhe Sanije Jusufit. Nji nga vizituesit ka shkrue keshtu ne librin perkates: „punimet e ketyne dy shoqeve shqiptare duhet te jene edhe nji nxitje per çduksjen e mendimeve te vjetra e per shkollimin sa ma te gjane te vajzave shqiptare".

Nxanesit e shkolles fillore kane ekspozue nji numer te madh lojna femijsh, etj. Ne nderteson e gjimnazit jane ekspozue vizatime te ndryshme, herbarjume, trupa gjeometrike etj.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Populluer Pajtimet ne Be tore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.